



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS**

**DHE ENERGISË**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE  
KAPITENERIA E PORTIT SARANDË**

Sarandë, më 10.01.2021

Lenda: Analiza JANAR – DHJETOR 2020 në Kapitenerinë e Portit Sarandë

Drejtuar: DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

**Objektivat e Realizuara nga Kapiteneria e Portit Sarandë.**

- Kapiteneria e Portit Sarandë ka kryer Monitorimin e Trafikut Detar në Portin e Sarandës, Portin e Limionit dhe në Gjiun e Sarandës 24orë/7dite.
- Për sezonin turistik veror 2020 ka kryer inspektimin për marjen e masave dhe sigurinë në plazhe së bashku me task-forcën e krijuar për këtë qëllim të cilën ka marrë pjesë në shumë takime të ndryshme të krijuara nga Prefekti Qarkut , Ministri të ndryshme dhe institucione të tjera.
- Ka kryer monitorimin nga afër te mjeteve turistike +12 pasagjer që nisen nga bankina e Limanit të qytetit,
- Ka kryer inspektime të ndryshme për plotësimin e standarteve të mjeteve turistike +12pasagjer me grupet e punës të ngritur nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.
- Ka marrë pjesë në shumë situata të ndryshme detare të cilat kanë qenë nën juridiksionin e saj.
- Ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me Rojen Bregdetare, Policinë Kufitare, Inspektoriatin e Peshkimit dhe autoritetet e tjera portuale për situata të ndryshme detare dhe portuale.
- Ka kryer kontrollin e mjeteve lundruese me flamur Shqipëtar dhe të huaj në nisje-mbërritje sipas konventës FAL.

## **Situata të ndodhura në periudhën Janar-Dhjetor 2020.**

- Situata të ndryshme për dhënie asistence të mjeteve të vogla lundruese të cilat kanë pasur avari në motor me flamur të huaj dhe flamur Shqipëtar në bashkëpunim me Policinë Kufitare dhe Rojen Bregdetare.

## **Situata dhe masat e marra për parandalimin e virusit "COVID-19".**

Në bazë të situatës aktuale në vendin tonë në lidhje me masat e marra për parandalimin e përhapjes së virusit **COVID-19** Kapiteneria e Portit Sarandë ka zbatuar të gjitha urdhërat e Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe ka marrë këto masa parandaluese si më poshtë :

- Njoftimin e gjithë institucioneve portuale të Portit Detar Sh.a Sarandë në vazhdimësi në lidhje me kufizimet e ndryshme sipas urdhërave dhe udhëzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme Detare.
- Zbatimi me rigorozitet i protokolleve dhe udhëzimeve mjeksore në ambientet e Kapitenerisë së Portit Sarandë.
- Për vitin - 2020 kemi patur 3(tre) raste me Covid-19 ku ndaj tyre dhe punonjësve të tjerë të cilët kishin pasur kontakt me personat e infektuar u zbatuan gjithë masat dhe udhëzimet e nevojshme mjeksore në përputhje me protokollet dhe udhëzimet e dhëna nga Ministria e Shëndetësisë.

## **Kapiteneria e Portit Sarandë për periudhën Janar-Dhjetor 2020 ka vënë re këto problematika :**

- Problematika të brendëshme në Kapitenerinë e Portit Sarandë nuk ka patur.

## **Problematika të përgjithshme për periudhën Janar – Dhjetor 2020:**

- Udhëzimet e reja për mjetet turistike deri 12 pasagjer / mbi 12 pasagjer ,kërkesat,ndryshimet, kodi detar.
- Kontrolli i kapacitetit të anijeve turistike (duhet gjetur një mënyrë e përshtatshme për ti kontrolluar)

- Rishikimi i udhëzimit për ekuipazhimin e anijeve turistike +12pasagjer.
- Përcaktimi dhe plotësimi i kërkesave të anijeve turistike duhet bërë përpara fillimit të sezonit turistik.
- Auditimi i anijeve turistike duhet bërë nga D.P.D-ja përpara se të marin certifikatën vjetore të R.SH
- Anijet turistike duhet të paisjen me LICENSE nga QKB për ushtrimin e këtij aktiviteti sipas kërkesave të përcaktuara nga D.P.D-ja me kodin përkatës .
- Menaxhimi më i mirë i mbetjeve të ngurta dhe vajore të anijeve turistike.
- Kontrolli i detajuar nga K.SH.F-ja ose K.SH.P për kërkesat për mjetet dhe paisjet e anijeve turistike.
- Mjetet e vogla lundruese turistike si gomone, jahte me flamur të huaj duhen kontrolluar për ushtrimin e aktivitetit në territorin e Republikës së Shqipërisë pasi është i ndaluar sipas Kodit Detar Shqipëtar.
- Mjetet e vogla lundruese turistike si gomone, jahte me flamur të huaj nuk flasin në radio kur hyjnë në Gjiun e Sarandës.
- Rishikimi i udhëzimit për mjetet e vogla lundruese turistike si gomone, jahte me flamur të huaj që vijnë nga portet e huaja dhe ato të brendshme.
- Rregullorja e Kapitenerisë së Portit Sarandë.
- Eksperti detar dhe paisja me LICENSE nga QKB për ushtrimin e këtij aktiviteti sipas kërkesave të përcaktuara nga D.P.D-ja duke krijuar kodin përkatës.
- Rishikimi i udhëzimit për rinovimin e dëshmive të drejtuesve me mjete lundruese për peshkim dhe për përdorim familjar të lëshuara më parë nga Kapiteneritë e Porteve.
- Unifikimi dhe përditësimi me format (leje-nisje, fatura, mandatet etj) të Kapitenerive në Republikën e Shqipërisë.
- Unifikimi dhe përditësimi i regjistrave (nisje, mbërritje, peshkimi, nafte etj) të Kapitenerive në Republikën e Shqipërisë.
- Unifikimi i regjistrimit për mjetet e vogla dhe anijet e peshkimit.

Me respekt

Kapiteni i Portit Sarandë

Fotin KONA